

Data 13.02.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: REF

“Rikonstruksion i godinës së Njësisë Qendër Tepelenë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi për ndërtesa multifunksionale 45211350-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 8.750.000 (tetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e mijë) leke pa tvsh .

Garancia per mbulimin te difekteve ,që mund te lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë 2 vjet .

Argumentim:

**MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS
LIMIT TË KONTRATËS**

Në zbatim të urdhërit të prokurimit nr , datw Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “pwr kryerje tw prokurimit “Rikonstruksion i godinës së Njësisë Qendër Tepelenë”

Grupi i punws , pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas Vendimit KB nr 87, datë 30.11.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afat mesem 2024-2026” dhe detajimin e buxhetit të bashkisë Tepelenë për vitin 2024”.
2. Shqyrtoi dokumentat e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, te hartuar nga: Grupi i projektuesve .

PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:
Specifikimet teknike të hartuar nga grupi i projektuesve objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TE KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 neni 76 ,sipas të cilit:

1. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve tëndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018”

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në përfundim të punës se grupit u vërejt se:

Grupi i punës u bazua në: projektin dhe preventivin, për projekt zbatimin e objektit:

“Rikonstruksion i godinës së Njesisë Qendër Tepelenë”

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve bazuar në një metodologji të paracaktuar, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës për prokurimin me titull.

“Rikonstruksion i godinës së Njesisë Qendër Tepelenë” rezultoi të jetë: 8.750.000 (tetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e mijë) leke pa tvsh ..

Mbështetur në rezultatin e sipër nxjerë, komisioni me unanimitet v e n d o s i :

Të përcaktojë Vlerën Limit të Kontratës; Për një shumë 8.750.000 (tetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e mijë) leke pa tvsh .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Tepelenë_ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës .3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, jo më të vogël se 40% të fondit limit të kontratës objekt prokurimi. .*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë e mallrave dhe punimet objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlera e xhiros duhet te jete ne masen 40% të fonit limit 3 680 000 (tre milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) Leke.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2 c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet të ketë realizuar të paktën:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është sa 100% e vlerës limit e kontratës ose lotit që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- Formular vlerësimi (Shtojca 9)
- Situacion përfundimtar të objektit,

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Situacionin përfundimtar të objektit;
- Fatura tatimore
- Vërtetim për kryerjen me sukses të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 dhe neni 55, pika 4/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Duke marrë ne konsiderate sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, si dhe punimet e kerkuara, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete bere me kontrata te ngjashme, te jete sipas parashikimeve ligjore. Ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me licence profesionale, ne fushen e zbatimit te punimeve, leshuar nga organet kompetente, e cilat te permbajne kategorite e meposhtme:

Punime ndertimi:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:

Kategoria NP-2 – Klasifikimi A

Kategoria NP-3 – Klasifikimi A

Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:

Kategoria NS-1 – Klasifikimi A

Kategoria NS-2 – Klasifikimi A

Kategoria NS-4 – Klasifikimi A

Kategoria NS-14 – Klasifikimi A

** Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.*

Shënim: *Ne rast pjesmarrjeje te nje Operatori ekonomik te huaj, ky i fundit, Licencen e mesiperme me kategorite e pershkruara, duhet ta kete te njehsuar prane organeve perkatese ne Republiken e Shqiperise sipas legjislacionit te saj ne fuqi.*

Argumentimi: Keto kategori punimi janë në përputhje me zërat e preventivit dhe objektin e prokurimit, janë proporcionale dhe te lidhura ngusht me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/a, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP 3 - A NP-2 N.S – 1.	Rikonstruksion dhe mirwmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash. Koordinim tw punimeve dhe specialiteteve tw nevojshwm pwr riaftwsim , konservim, konsolidim,transformim, rivlerwsim ristrukturim.finitura tw ndryshme qw lidhen me objketin , punime plotwsuese dhe pajisje. Ndërtime civile dhe industriale.	Punime prishje		1,273,960
NP 3 - A NP-2 N.S.- 4 N.S – 1		PUNIME MURATURE		256,073
NP 3 - A NP-2		PUNIME KONSTRUKSIONI DHE CATIE/MBULESE		103,038
NP 3 - A NP-2 N.S.- 4		PUNIME SHITESASH PER DYSHEME		753,783
NP 3 - A		PUNIME SUVATIMI, LYERJE DHE VESHJE		3,392,792

NP-2 N.S.- 4				
NP 3 - A NP-2		PUNIME DRITARE DHE DYER		1,809,095
NP 3 - A NP-2 N.S- 2		PUNIME HIDRAULIKE		169,798
NP 3 - A NP-2		PUNIME TARACE-CATIE DHE H/IZOLIMI I SAJ		719,878
NP 3 - A NP-2 N.S - 14		PUMIME ELEKTRIKE		679,517
NP 3 - A NP-2		PUNIME MKZ		42,066

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht punonjesit si me poshte vijon:

- Si drejtues teknik te perfshire ne licencen e shoqerise te pakten 1 (nje) inxhinier ndertimi, 1 (nje) inxhinier hidroteknik. 1 arkitekt,
- Gjithashtu si pjese e stafit te tij ofertuesi pervec inxhiniereve te mesiperm duhet te kete dhe 1 (nje) inxhinier elektrik

Inxhinieret e mesiperm duhet te jene te siguruar dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-Sig per per të paktën muajin e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: kontratat individuale te punes, shoqeruar me diplomat perkatese te inxhiniereve te mesiperm, si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për inxhinieriët e sipërcituar është në përpjestim dhe e lidhur me objektin e kontratës, punimet që do të kryen, të parashikuara në preventiv, respekton edhe parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë minimale e mundur të plotësohet nga cdo OE që ka në objektin e vet tregëtar keto lloj niveli punimesh. Keto kërkesa për kualifikim janë në përputhje me pikën 6, të Nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe Nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë me shkrim se inxhinieret e përkrahur në pikën 2.3.3 për kualifikim janë të pa angazhuar në kontrata të tjera dhe, në rast se shpallen fitues për këtë procedurë, do të qëndrojnë në objekt gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e deklaratës.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur me qëllim për garantimin se OE ofertues do të realizojë kontratën objekt procedure prokurimi me prioritet dhe pa vonesa. Realizimi i kësaj kontrate do të bëhet në përputhje me normat e sigurisë së Autoritetit Kontraktor, me stakime e nevojshme të koordinuara dhe për këtë qëllim duhet që OE ofertues ta realizojë atë me angazhim të plotë të stafit të tij.

2.3.5 Numri mesatar i punonjësve duhet të jetë jo më pak se **25 (njëzetë e pesë) punonjës** për periudhën **Tetor 2023 - Dhjetor 2023**. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën **Tetor 2023 - Dhjetor 2023**.
- b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Tetor 2023 - Dhjetor 2023**.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet listëpagesat përkatëse E-Sig.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me numrin e fuqisë mesatare punëtore të siguruar, duke patur parasysh volumet e punëve objekt kontrate, natyrën dhe vlerën e kontratës, ky numër punonjësish është proporcional dhe i lidhur me aftësinë zbatuese, me qëllim realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës. Numri i punonjesve është perlllogaritur duke patur në konsideratë volumin e punës për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/ç, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.6 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin teknik mbështetës të punësuar të vërtetuar me kontrate pune të vlefshme, si dhe të figurojnë në listë pagesat e shoqërisë për periudhën **Tetor 2023 - Dhjetor 2023**

a) 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë/dëshmi si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", i ndryshuar, lëshuar nga organizatë shqiptare ose e huaj e njohur në Republikën e Shqipërisë, të shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, diplomë/certifikatë si dhe të figurojë në listëpagesa për periudhën **Tetor 2023 - Dhjetor 2023**.

b) Operatori/ët ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ certifikuar si: 1(një) Punonjës ekspert zjarrfikës i certifikuar në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi lëshuar nga MZSH.

c) Operatorët ekonomikë ofertues me qëllim respektimin e standardeve të sigurisë konform ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, duhet të dëshmojnë se kanë pjesë të stafit të shoqërisë personel të trajnuar/certifikuar për punimet në lartësi (montim skeleri/veshje fasade me polisterol/veshje fasade me mermer/veshje fasade me alukoband, etj), jo më pak se 2 (dy) punonjës.

Për këtë duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- certifikata dhenë nga një organizëm certifikimi i akredituar shqiptar ose i huaj.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën për personelin e certifikuar për punime në lartësi, personi përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e personelit në punë, si he punonjës të certifikuar në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, lëshuar nga MKZ, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë dhe të paraqesë certifikatën përkatëse të punonjesve që do të kryejnë punimet objekt kontrate. Një numer i tillë të siguruarish është kërkuar pasi punimet objekt procedure prokurimi kërkojnë punonjës të kualifikuar dhe të aftë, që të punojnë sipas kërkesave të sigurisë në punë për të shmangur rrezikun për jetën, shëndetin dhe çdo problem tjetër, gjatë zbatimit të kontratës.

Persa i perket kerkeses per nje punonjes te trajnuar dhe te pajisur me certifikate si pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune me rrisk te larte, argumentohet se eshte i nevojshem te qendroje ne kantierin e punimeve per te ndjekur ecurine e punes se punonjesve te OE ofertues dhe te jete i gatshem ne rastin e paraqitje se kushteve te rrezikshme qe mund te ndodhin gjate zbatimit te kontrates objekt prokurimi, ne perputhje me Ligjin Nr. 10237, date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të kenë ne stafin e tij punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me te, të vlefshme, minimalisht per periudhen e 3 (tre) muajve te fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, nga te cilet minimalisht te mbajne profesionet si me poshte vijon:

- Punonjës Teknik ndërtimi 1 (një)
- Punonjës Murator 1 (një)
- Punonjës Suvaxhi 2 (dy)
- Punonjës Hidroizolues 2 (dy)
- Punonjës Bojaxhi 1 (një)
- Punonjës Hidraulike 2 (dy)
- Punonjës Elektracistë 2 (dy)
- Punonjës Pllakashtrues 2 (dy)
- Specialist gipsi 2 (dy)
- Punonjës duro-alumini 2 (dy)

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues për punonjësit e mësipërm duhet të disponoje kontratat e punës te vlefshme; deshmite e kualifikimit te sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për periudhen e kerkuar.

Përvec si me sipër, per punonjesit teknik ndertimi duhet te paraqitet dokumenti qe verteton kualifikimin (deftese dhe/ose diplome).

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën për personelin e pajisur me kartelat e sigurimit teknik, operatori ekonomik ofertues duhet të disponoje dhe të paraqese kartelat përkatëse të punonjësve që do të kryejnë punimet objekt kontrate. Një numer i tillë të siguruarish është kërkuar pasi punimet objekt procedure prokurimi kërkojnë punonjës të kualifikuar dhe të aftë, që të punojnë sipas kërkesave të sigurisë në punë për të shmangur rrezikun për jetën, shëndetin dhe cdo problem tjetër, gjatë zbatimit të kontratës.

Punonjesit qe do te realizojne kete kontrate, per arsye te natyres teknike te saj dhe kushteve te punes, duhet te respektojne rregulloren e sigurimit teknik, bazuar ne dispozitat ligjore perkatese.

Kjo kerkese eshte ne perputhje me Nenin 77, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", si dhe pika 6/c, e nenit 39, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO, te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:

- ✓ *ISO 9001: per Sistemin e menaxhimit te cilësisë, qe ka lidhje me objektin e prokurimit.*
- ✓ *ISO 14001: per Sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit, qe ka lidhje me objektin e prokurimit.*
- ✓ *ISO 45001: per Sistemin e menaxhimit të sigurise ne pune, qe ka lidhje me objektin e prokurimit.*

Certifikata per sistemin e menaxhimit te cilesise ISO 9001: eshte sot referimi i njohur ne nivel nderkombetar, per certifikimin e sistemit te menaxhimit te cilesise te kompanive te te gjithë sektoreve dhe te gjithë permasave. Ky kriter kerkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve nderkombetare të objektit të kontratës.

Certifikata e menaxhimit të cilesisë së mjedisit ISO 14001: e kerkuar nga AK garanton se OE ofertues eshte i certifikuar per produkte te cilat nuk demtojne mjedisin dhe nuk e ndotin ate dhe qe jane konform standardeve nderkombetare te cilesise.

Certifikata për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001: eshte vendosur si kriter kualifikues per operatorët ekonomik ofertues sepse ka te beje me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila eshte me nje rendesi te vecante per kryerjen e kesaj kontrate. OE ofertues qe do te realizoje kontraten objekt procedure prokurimi duhet te kryeje punimet objekt procedure prokurimi dhe kjo kategori licence minimizon rreziqet qe mund te shfaqen gjate realizimit te kesaj kontrate.

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2.3.9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë / broshurë ose fragmente (faqe) të katalogut/eve ose skedat teknike, për materialet që do të ofrohen respektivisht, elektrike, hidraulike, paisje hidrosanitare, pllaka, boja, gipse dhe dritare, të shoqëruar me çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE ose çertifikata cilësisë ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, duke markuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilën, me specifikimet

përkatëse të markuara , në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me kërkesat e specifikimeve teknike në DT.

2.3.9/1 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të provojnë që janë të autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për tregtimin e artikujve/pajisjeve që do të përdoren në funksion të realizimit të zërave përkatës të preventivit të punimeve (sipas listës së përcaktuar në DT). Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 77, 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 4, dhe neni 40 pika 6b e në vijim të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

2.3.10 Për ato zëra punësh që nuk ndodhen në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, të ndryshuar ofertuesit duhet të paraqesin analizat teknike të tyre, sipas formatit të miratuar.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1.	Kamiona vetëshkarkues, kapaciteti total mbajtës minimumi 5 ton	në pronësi ose me qera	copë	1
2.	Kamionçinë me kapacitet total mbajtës 3.5-5 ton	në pronësi ose me qera	cope	1
3.	Kamion me vinç, minimumi 6 ton	në pronësi ose me qera	cope	1
4.	Dumper me targa	në pronësi ose me qera	cope	1
5.	Autobetoniere me targë	në pronësi ose me qera	cope	1
6.	Matrapik	në pronësi ose me qera	copë	1
7.	Gjenerator	në pronësi ose me qera	copë	1
8.	Prerëse pllakash (troko)	në pronësi ose me qera	copë	1
9.	Betoniere	në pronësi ose me qera	copë	1
10.	Kazma	në pronësi ose me qera	copë	3
11.	Ballades me kabëll	në pronësi ose me qera	copë	2

12.	Cekic	në pronësi ose me qera	copë	2
13.	Shkallë	në pronësi ose me qera	copë	1
14.	Elektrogur	në pronësi ose me qera	copë	2
15.	Trapan	në pronësi ose me qera	copë	2

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier" (i ndryshuar) me VKM-në nr.563, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndeti për përdorimin e paisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës", dhe VKM-në nr.564, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës" si më poshtë vijon:

- Kokore mbrojtëse minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 1 (një) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 2 (dy) copë
- Karroca dore minimumi 2 (dy) copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 2 (dy) copë
- Fikse zjarri 2 (dy) copë
- Jelekë minimum 15 (esëmbëdhjetë) copë

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- a) kontrata e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit dhe foto të tyre.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, i cili vërteton se operatori ekonomik disponon mjetet sa më sipër, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet mbi makineritë sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Mjetet dhe pajisjet teknike të vendosura si kërkesë për tu plotësuar nga OE, janë të domosdoshme për punimet gjate realizimit të kontrates objekt procedure prokurimi, për realizimin e punimeve që do të kryhen në kantier. Kjo kërkesë është minimale dhe jodiskriminuese në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/d, të nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.12 Në funksion të plotësimit të Shtojcës 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratoret e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posacem të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor, ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punimet objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe nderkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Njesia e prokurimit